

URDHËR
Nr. 219, datë 31.7.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, vendimit nr. 103, datë 4.2.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, z. Arjon Bistri, drejtor i Drejtorisë Juridike të Miradministrimit Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit.
2. Kompetencat, sipas përcaktimit të pikës 1të këtij urdhri, të ushtrohen nga data 5.8.2019 deri më datë 15.8.2019.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri drejtori i Drejtorisë Juridike të Miradministrimit Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTOR
Armando Lamaj